



VENDIM

Nr. 30 Datë 31.03.2014

PËR
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “AYEN ELEKTRIK TRADING”
Sh.A NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 3 pika 31, nenit 8 pika 2, gërma “a”; nenit 9, dhe nenit 45 pika “4”; nenit 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, ne zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “f”; nenit 5, pika 1, gërma “f”; nenit 12; nenit 13; nenit 14 pika 1, gërma “f” të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.03.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AYEN ELEKTRIK TRADING” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “AYEN ELEKTRIK TRADING ” Sh.a plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “AYEN ELEKTRIK TRADING” Sh.a në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike, me nje afat 5 vjecar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI